



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 493 prot.

Ballsh më. 30 . 01 .2026

VENDIM

Nr. 04 Datë 29.01 .2026

**“PËR
PAGESËN E VLERËS SË QIRASË FAMILJES SË Z. ARJAN SHEHAJ, BANOR I
FSHATIT DAMËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE FRATAR, BASHKIA
MALLAKASTËR”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3, gërma d, Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, evidentimeve të kryera nga ana e strukturave të Bashkisë Mallakastër (Sektori i Mbrojtjes Civile) në lidhje me dëmtimin e banesës së qytetarit, si dhe kërkesës së paraqitur pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 111 Prot., datë 12.01.2026.

VENDOSI

1. Pagesen e vlerës së qirase për familjen e **Z. Arjan Shehaj**, banor i fshatit Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër, familje e cila ndodhet në kushte të vështira financiare dhe banesa është e dëmtuar. Vlera e qirasë e propozuar është deri në masën 10 000 (dhjete mijë) lekë në muaj për një periudhë 1 vjeçare (12 muaj), me të drejtë rinovimi për një periudhë 1-vjeçare (në rast disponibiliteti financiar të Bashkisë Mallakastër).
2. Shpenzimet e vlerave të qirasë do të mbulohen nga të ardhurat e Bashkisë Mallakastër.
3. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues dhe dokumentacionin shoqerues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

